


Statistika 2014


Ne zyrën e Informacionit Turistik, për vitin 2014 janë ndërmarrë anketime të vizitorëve si dhe të bizneseve dhe komunitetit. Më poshtë janë rezultatet paraprake të anketimeve. Anketimet përfundimtare për vitin 2014 do të dalin në fund të vitit.

Anketimet janë realizuar mbi një kampion prej 150 turistësh të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme.

Mosha e turistëve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014. Sipas statistikave turistët e grupmoshës 26-30 vjeç janë më të shumtë që vizitojnë qytetin në mënyrë të pavarur.



Gjinia e Turistëve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014.
62% e vizitorëve në Berat kanë rezultuar se janë meshkuj, ndërsa pjesa tjetër femra.




Vizitorët të ndarë pas mënyrës së udhëtimit: në grup apo vetëm

77% e turistëve që vizituan qytetin ishin në Shoqërinë e personave të tjerë, ndërsa 19% udhëtonin vetëm.




Origjina e Turistëve të anketuar në Zyrën e Informacionit Turistik

Sipas kampionit të anketuar, turistët që kanë vizituar më tepër qytetin e Beratit janë Gjermanë, duke vijuar më pas me francezë, Italianë, Polakë, Anglezë, Hollandezë etj.



Ditët e Qendrimit në Shqiperi



VIZITORË NË KALANË E BERATIT (Sipas Biletave të Shitura në Kalanë e Beratit)

Vizitorë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Të huaj	413	219	331	107 2	266 4	242 7	313 5	420 6	395 6		309	262	1873 2
Vendas	564	391	439	393	612	673	945	164 4	134 4		436	804	7441
Pa biletë	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0		0
Studentë	25	0	30	200	950	800	0	0	0		50	50	2055
Totali	1002	610	800	166 5	422 6	390 0	408 0	585 0	530 0	48 15	795	111 6	3415 9

Vizitorë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Numri	24	23	87	113	142	254	219	453	232	190	156	40	1938

VIZITORE NE ZYREN E INFORMACIONIT TURISTIK

Të ardhurat kryesore nga turizmi vijnë kryesisht nga biletat e shitura në Kalanë e Beratit dhe në dy Muzetë Kombëtarë. Sektori privat ka pasur një rritje të konsiderueshme. **SIPAS TË DHËNAVE NGA SHITJA E BILETAVE, REZULTON SE DERI në Muajin Nëntor të vitit 2014 kanë ardhur 34.159 turistë, ndërsa në vitin 2013 numri i turistëve deri në muajin Dhjetor ishte 22.046. Rritja e numrit të turistëve është me mbi 50% për këtë vit.** Sipas Agjencisë së Zhvillimit të Turizmit, Berati është destinacioni kulturor i preferuar i turistëve që vijnë të vizitojnë Shqipërinë për turizëm kulturor dhe natyror.

AKOMODIMI: Në vitin 2014 Berati ka 32 hotele dhe shtëpi pritëse, ndërsa disa të tjera janë duke u ndërtuar. Një sërë shtëpi pritëse janë hapur së fundmi në shtëpitë tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë.

USHQIMI DHE PIJET

Janë gjithsej 29 restorante në qytetin e Beratit të cilat janë të orientuara kryesisht në drejtim të shërbimit të turistëve. Ato ofrojnë si kuzhinë tradicionale ashtu edhe kuzhinë ndërkombëtare, kryesisht Italiane.

SHËRBIMET TURISTIKE:

Berati ka katër agjenci udhëtimi që operojnë kryesisht për dërgimin e turistëve vendas jashtë shtetit. Asnjë agjenci nuk shet aktualisht ture të organizuara në rajon megjithëse këto ture organizohen në bazë të kërkesave të çastit.

PROJEKTE

Krijimi i Forumit Turistik, me përfaqësues nga të gjitha institucionet dhe bizneset - Qëllimi i Forumit Turistik është të ofrojë udhëzim dhe asistencë për institucionet publike dhe bizneset private që të bashkëpunojnë drejt qëllimit të zhvillimit turistik në rajonin e Beratit dhe krijimit të një njësie gjithëpërfshirëse me përfaqësues publik, kompani private dhe anëtarë të komunitetit, duke siguruar përmbushjen e interesave të përbashkëta. Për t'a arritur këtë, forumi do të ofrojë asistencë në fushat e mëposhtme:

Komponenti 1: Të krijojë propozime dhe programe të përbashkëta për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Komponenti 2: Të fuqizojë zërin e komunitetit nëpërmjet një procesi të vlerësimit të nevojave.

Komponenti 3: Të përmirësojë transparencën dhe ndarjen e informacionit për të trajtuar gjendjen aktuale dhe projektet e ardhshme.

Komponenti 4: Të ofrojë një njësi mbështetëse për projekte ndër-sektorale të cilat kanë ndikim mbi grupet e interesit.



Projekt i Dites se Gatimeve Tradicionale

Në datat 23-31 Dhjetor në Qytetin e Beratit u organizuan Festat e Fundvitit. Në kuadër të kësaj feste, u zhvillua Panairi i Gatimeve Tradicionale të qytetit të Beratit. Objektivat e këtij projekti ishin promovimi i traditës së gatimit tradicional në qytetin e Beratit, mbështetja e të rinjve në përfitim të zanateve dhe traditave qytetare si dhe nxitja e bizneseve nëpërmjet promovimit të produkteve karakteristike ushqimore të trevës së Beratit. Gjithashtu, synimi ishte promovimi edhe më shumë i vlerave tradicionale muzikore, produktet a agrobiznesit dhe produktet artizanale.

Në kuadër të këtij projekti u kryhen trajnime profesionale në gatime tradicionale. Në datat 22,23,24, të rinjë nga Qendra e Formimit Profesional Leta, nxënës nga Shkolla e mesme e Formimit Profesional Kristo Isak, Hotelieri Turizëm si dhe të rinj nga komuniteti Rom dhe Egjiptian morrën pjesë në trajnimet e organizuara nënë drejtimin e Mjeshtrit kulinar Josif Mio si dhe instruktore të tjerë.

Pas përfundimit të trajnimeve, në datën 25 Dhjetor, u organizua Panairi i Gatimeve Tradicionale ku të rinjtë e trajnuar morrën pjesë me gatimet e tyre tradicionale.

Ky projekt u mundësua me ndihmën e Bashkisë Berat, Qendra e Trajnimit Profesional Leta, Risi Albania, Fondacioni Ndihmë për Fëmijë si dhe projekti UNDP për përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe egjiptiane.



Projektit për Trajnimin dhe Certifikimin e Guidave ne qytetin e Beratit.

Në bazë të analizave, dhe rezultateve të anketave të ndërrmara me komunitetin dhe turistët e huaj në qytet, trajnimi dhe certifikimi i guidave turistike ka rezultuar si një nevojë e menjëhershme që duhej adresuar.

- Programi zgjati 2 javë në datat 15 Shtator – 27 Shtator. Në program u përfshinë 15 Guida Turistike nga komuniteti.
- Lëndët që u trajtuan ishin Turizmi dhe Ligjet e tij, Anglishtja për Turizmin, Historia e Shqipërisë, Beratit dhe monumenteve të tij kulturore dhe natyrore, UNESCO, kujdesi ndaj klientit dhe Hartimi i Planeve të Biznesit.
- Për këtë trajnim u hartua një program i cili nënvijëzon mënyrën dhe hapat e trajnimit dhe dhënies së informacionit, si dhe kurrikulat e detajuara.

Ne fund të trajnimit, pjesëmarrësit morën një Certifikatë Arritje, si dhe secili prej tyre do krijoi një Plan Biznesi.



Marrëveshje Partneriteti me Shkollën e Mesme Profesionale Kristo Isak – Me anë të kësaj marrëveshje, dy organizatat, Bashkia Berat dhe Shkolla e Mesme Kristo Isak, Hoteleri Turizëm, do të zhvillojnë një program në të cilin nxënësit nga shkolla Kristo Isak të dedikojnë disa orë për të punuar në një numër projektsh profesionale me Zyrën e Informacionit Turistik në Bashkinë Berat. Partneriteti do të integrohet si pjesë e kurrikulës së shkollës për ofruar nxitje për nxënësit e motivuar që të marrin pjesë.

Objektivat e Programit: Të ofrojë për nxënësit trajnim dhe zhvillim profesional, të angazhojë nxënësit në një mjedis pune dhe t'u japë atyre eksperiencë praktike, të krijojë një rrjet bashkëpunues institucionesh publike brenda qytetit të Beratit.

MARRËVESHJE
PARTNERITETI NË FUSHËN E RITJES SË KAPACITETEVE NË FUSHËN E
TURIZMIT
NDËRMJET
BASHKISË BERAT,
DHE
SHKOLLËS PROFESIONALE KRISTO ISAK

Bashkia Berat dhe Shkolla Profesionale Kristo Isak, në vazhdim të referuara si "palë",

Duke njohur rëndësinë e rritjes së kapaciteteve dhe promovimit dhe zhvillimit të turizmit në qytetin e Beratit, si një nga degët më të rëndësishme të zhvillimit të komunitetit,

Si dhe duke pasur një qëllim të përbashkët për zhvillimin e turizmit në shërbim të komunitetit,

Bien dakord si vijon:

.. .

Zhvillimi i Turizmit Kulturor në qytetin e Beratit

Me anë të këtij projekti ne synojmë: a) të zhvillojmë sitin kulturor të qytetit të Beratit si një sit turistik konkurrent, b) përdorimin e potencialit të turizmit për të rritur punësimin në komunitet dhe c) rritjen e aftësive të banorëve të komunitetit për të pasur mundësi që të përfitojnë sa më shumë nga potenciali turistik i qytetit për punësim.

Ndër aktivitetet që ne parashikojmë në kuadër të këtij projekti janë ofrimi i trajnimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve në aftësi interpretuese, aftësi sipërmarrëse (krijimi i Planeve të Biznesit), hartimin dhe prodhimin e produkteve artizanale, aftësi të jetës,

trajnim në gjuhë të huaj etj. Aftësitë e menaxhimit të trashëgimisë si dhe të rritjes së ndërgjegjësimit janë gjithashtu të nevojshme për të siguruar një mirëmbajtje afatgjatë të trashëgimisë, duke siguruar në këtë mënyrë një turizëm të qëndrueshëm.

Organizimin e dy Tavolinave të rrumbullakëta në kuadër të Projektit Risi Albania nga Partners – Qëllimi i këtyre tavolinave të rrumbullakëta me grupet e interesit ishte identifikimi i projekteve dhe aktiviteteve të mundshme dhe mbi mënyrën e menaxhimit më të mirë të turizmit në Qendrën Historike.



Projekti IPA II – Rijetezimi i Kalase se Beratit

Studimi i fizibiliteteve te tre projekteve qe do te financohen nga Komisioni Evropian dhe Bashkia Berat per kalane e Beratit. Projektet jane: Restaurimi i Kulles se Tabjes, Rregullimi kanalizimeve te ujerave te bardha dhe te zeza si dhe Restaurimi i rruges se kalase nga merkatoja deri ne ne qafen e kalase.




Realizimi i Statistikave në bazë të anketave në Zyrën e Informacionit Turistik - Për vitin 2014, zyra e informacionit Turistik ka ndërmarrë kryerjen e statistikave të rregullta ndaj vizitorëve që vijnë ta vizitojnë zyrën dhe të marrin shërbime. Në fund të vizitës së tyre turistët plotësojnë një anketë paraprake me pyetje themeltare. Turistët ftohen të lënë adresat e tyre të emailit në të cilat dërgohen anketa elektronike

më të detajuara. Të dhënat e përftuara vendosen në sistem kompjuterik nga dhe ku përpunohen.

Statistika

Dizenjimi dhe Pririmi Anketave për Turiste dhe Biznese Turistike. Shpendarja e Anketave pranë Bizneseve Turistike dhe Turisteve, grumbullimi dhe përditësimi i informacionit të ri turistik.

Mosha e turisteve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014.



Gjinia e Turisteve që kanë vizituar Zyrën e Informacionit Turistik për vitin 2014



Vizitorët të ndarë pas mënyrës së udhëtimit: në grup apo vetëm



Organizimin e Takimit me Ministren e Turizmit Eglantina Gjermani për hartimin e Draft Strategjise Kombetare – Ekspertët dhe drejtues lokalë të qytetit të Beratit dhënë opinionet dhe sugjerimet e tyre mbi ligjin e ri për turizmin. Ministrja Eglantina Gjermani nisi në qytetin e Beratit procesin e konsultimeve me publikun dhe grupet e interes mbi draft Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2014 -2020.



Hapja e Qendres Rinore Berat (12 Prill)

Ne datën 12 në Bibliotekën e Qytetit është hapur Qendra Rinore Berat. Qendra Rinore Berat ka si qëllim të ndihmojë të rinjtë në Berat të zhvillojnë më shumë interesat e tyre në një mjedis që nxit të mësuarin. Ajo u krijua pas një bashkëpunimi midis Korpusit të

Paqes, Bashkisë Berat dhe Bibliotekës Vehxhi Buharaja. Në hapjen e sa kanë kontribuar në vitë shumë kontribuues ku ndër më të spikaturit janë Vullnetarët e Korpusit të Paqes. Kjo qendër aktualisht është me përmasa modeste por do t'i shërbejë komunitetit deri në hapjen e një qendre me të madhe.



Projekte ne Proces

**Zhvillimi i Produkteve Turistike, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe
Zhvillimit Urban**

Në kuadër të këtij projekti do të synohet krijimi i një produkti ose itinerari turistik. Ndër itineraret dhe produktet e propozuara janë: Itinerari i Veres, Kalaja e Goricës, Trashëgimia Komuniste, Rijetëzimi i Monumenteve Ekzistuese, Krijimi i një Festivali Vjetor, Krijimi i një Panairi, Krijimi i një tregu dhe produkteve të reja Artizanale

Projekti Hera – Turizmit i Trashëgimsë së Adriatikut

Projekti Hera është një projekt që fokusohet në zhvillimin e turizmit kulturor në vendet e Adriatikut. Ai financohet nga Komisioni Evropian dhe përfshin shumë vende partnere. Eksperienca e ndare është e vlefshme në kuadër të krijimit dhe implementimit të politikave rajonale. Në kuadër të këtij projekti do të synohet që qyteti i Beratit të lidhet në një rrjet iteneraresh me qytetet të tjera të Adriatikut si dhe të promovohet më shumë brenda shteteve fqinje.

Projekti nga Federata Shqiptare e Rafting

Ky projekt do të kryhet në partneritet me Bashkinë. Objektivat e tij janë ndërtimi i kapaciteteve të rinjve duke u mundësuar atyre të kenë më shumë undësi për punë si dhe të kryejnë aktivitete që gjenerojnë të ardhura në industrinë e turizmit.

Objektivi 2. Krijimi i produkteve turistike rajonale dhe locale të cilat zhvillohen për të rritur shërbimet locale dhe rajonale të produkteve turistike.

Objektivi 3: Përmirësimi i faqes së internetit visitberat.al e cila bazohet në shërbime të sukseshme rajonale dhe të cilat do të apelojnë si për tregjet turistike të brendshme ashtu dhe ato të jashtme.

Projekti EVS – Shërbimi Vullnetar Evropian

Në kuadër të projektit EVS të programit Erasmus+, Organizata SIJ në Francë me bashkëpunimin e Bashkisë sonë ka aplikuar dhe ka fituar projektin për dërgimin e një vullnetari Francez në Berat për të implementuar disa nga pikat e Projektit të Rehabilitimit të Lumit Osum të Hartuar nga Kompania SICALA. Midis financimeve që jep Komisioni Evropian ka edhe një pagesë për financimin e aktiviteteve të Vullnetarit. Projektet do të fokusohen në menaxhimin e ujërave, ruajtjen e mjedisit në Shtratin e Lumit Osum dhe në Qendrën Historike.

Projekte për Qendrueshmerine e Projektit SUSTCULT

Në kaudër të qendrueshmërisë së projekti Sustcult, kemi propozuar tre projekt ide të tjera të cilat mund të mbështeten nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri. Tre projekt idetë e propozuara janë krijimi i **Planeve të Përbashkëta të Menaxhimit me Qytetin e Gjirokastrës**, **krijimi i një Kapi Rinor Restaurimi** si dhe **krijimi i produkteve turistike, si ato artizanale**. Jemi në pritje të përgjigjes së Delegacionit të Komisionit Evropian.

Projekte për Vitin 2015

PAKETA PROMOVUESE BERAT			
Lloji	Cope	Çmimi (Lekë)	Totali
Harta turistike	2000	20	40.000

18 PRILL, DITA E MONUMENTEVE TË KULTURËS			
Fletëpalosje	1000	30	30.000
Kalendar Festash	1000	30	30.000
Fletëpalosje me Itenerare	1000	30	30.000
Baner Palosës	2	20.000	40.000
Ekspozitor	1	35.000	35.000
Banera 2.30 x 1.00	4	5.000	20.000
Dizajni	8	2.000	16.000
Totali			241.000

PJESËMARRJE NË PANAIRE			
Lloji	Numri	Çmimi	Totali
Panair Kombëtar	1	150.000	150.000
Panair Ndërkombëtar	1	200.000	200.000
Materiale Plotësues: Baner Ballor 4m x 2.30	1	21.000	21.000
Baner Projektsh 2mx2.30	2	10.500	21.000
Raport Projektsh	200	100	20.000
Totali			412.000

PAJISJE JETIKE PËR ZYRËN E INFORMACIONIT TURISTIK			
Lloji	Nr.	Cmimi	Totali
Kompjutera	2	50.000	100.000
Printer	2	20.000	40.000
Modem Wireless	1	3.000	3.000
Aparat Fotografik	1	15.000	15.000
Totali			158.000

KALENDARI I FESTAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË:

Data	Aktiviteti	Vlera	Totali
18 Prill, Dita e Monumenteve të Kulturës	Vlerësim për restaurimin më të mirë të bërë nga qytetarët	15.000	15.000
	Tavolinë e rrumbullakët me aktorët e mbrojtjes së Trashëgimisë	30.000	30.000
Totali			45.000

15 MAJ, HAPJA E SEZONIT TURISTIK			
Data	Aktiviteti	Vlera	Totali
15 Maj, Hapja e Sezonit Turistik	Konferenca: Turizmi dhe Standardet (Ftohen Operatorët Turistik Kombëtar)	150.000	150.000
Totali			150.000

8 KORRIK, HYRJA E BERATIT NË UNESCO			
Data	Aktiviteti	Vlera	Totali
8 Korrik, Hyrja e Beratit në UNESCO	Panair Artizanati	150.000	150.000
	Konkurs për Produktin më të mirë të Artizanatit	30.000	30.000
	Ekspozita Harmonia Fetare dhe Dialogu Ndërkombëtar	20.000	20.000
Totali			200.000

27 SHTATOR, DITA NDËRKOMBËTARE E TURIZMIT				
Data	Aktiviteti	Vlera	Totali	Data

27, Dita Ndërkombëtare e Turizmit	Certifikim i Hoteleve dhe Restoranteve me standarde të mira në cilësi	Publikim i Statistikave dhe Projekteve	65.000	65.000
		Publikim i Statistikave dhe Projekteve	15.000	15.000
		Tavolinë e rrumbullakët me aktorët lokal: Sfidat dhe Arritjet	25.000	25.000
Totali				105.000

29 SHTATOR, DITA KOMBËTARE E TRASHËGIMISË KULTURORE			
Data	Aktiviteti	Vlera	Totali
27, Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore	Kamp Restaurimi Rinor	40.000	40.000
	Prodhim, ekspozitë dhe demonstrim i veshjeve Popullore Beratase	60.000	60.000
	Koncert me Këngë qytetare Beratase	15.000	15.000
Totali			115.000

FESTA E VERËS DHE PANAIRI I GATIMEVE TRADICIONALE			
Data	Aktiviteti	Vlera	Totali
2 Tetor, Dita e Gatimeve Tradicionale	Panair Verash dhe Gatime Tradicionale	150.000	150.000
Totali			150.000

PROJEKTE INFRASTRUKTURE

Përmirësimin e Aksesit ne Kalanë e Goricës		
Projekti	Aktivitetet	Kosto
Rregullimi i Rrugës qe te çon ne Kalanë e Gorricës	Pastrimi dhe sistemimi i trakut	
	Vendosja e tabelave informuese	
	Pastrimi dhe sistemimi i rrënojave	
	Krijimi i një mjedisi rekreativ dhe vendosja e koshave	

Rregullimin Mjedisor te Kalasë se Beratit		
Projekti	Aktivitetet	Kosto
Rregullimin Mjedisor te Kalasë se Beratit	Vendosja e koshave te mbeturinave te përshtatshme	
	Pastrimin e mbetjeve te depozituara	
	Vendosja e tabelave informuese	
	Shtimin e kohës se pastrimit	
	Rregullimin e trakut përgjatë mureve te Kalasë	

Përmirësimin e Aksesit në Bunkerat në Lindje të Kalasë		
Projekti	Aktivitetet	Kosto
Rregullimi i Rrugës qe te çon ne Kalanë e Gorricës	Pastrimi dhe sistemimi i trakut	-
	Vendosja e tabelave informuese	
	Pastrimi i Bunkerave	

EVENTE

Organizimi i Panairit te Gatimeve Tradicionale – Në datën 25 Dhjetor, Bashkia Berat në bashkëpunim me Qendren e Formimit Porfesional Leta, Risi Albania, Fondacionin Ndhme per Femije dhe Projektin e UNDP per perfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, organizoi panairin e gatimeve Tradionale. Në panair morrën pjesë të rinj dhe të reja nga instituicente e mësipërme të cilët ishin trajnuar më parë në fushën e gatimeve tradicionale. Projekti u organizua dhe u kordinua nga Bashkia berat, Zyra e Informacionit Turistik.



Pjesemarrje ne Panairin Nderkombetar te Tiranës - Në datat 22-26 Nëntor, Bashkia Berat mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës. Në panair u promovuan burimet turistike të qytetit të Beratit, produktet e bizneseve si dhe projektet në fushën e turizmit dhe zhvillimit urban. Stenda e Bashkisë ngjalli interes të madh ndërmjet vizitorëve dhe ndër të tjerë u vizitua nga Ministri i Energjetikës, Z. Damian Gjiknuri, Zv. Ministri i Turizmit, Z. Alfred Dalipi, Zv. Ministria e Arsimit Znj. Nora Malaj, Zv. Ministri i Kulturës, Z. Zef Cuni etj. Kontaktet ishin të shumta edhe me specialistë të Ministrisë së Turizmit dhe Zhvillimit Urban, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, operatorë turistikë, donatorë etj.

Stenda e Bashkisë, përveç dekorimit, ofronte shërbime dhe produkte. Operatorët turistik prezantoheshin me produkte si dhe u ofrohej një anketë për të shprehur nevojat dhe kërkesat e tyre. Shkëmbimet ishin edhe më intensive me biznesit prezente në panair.



Bashkepunim dhe Shoqerim te Studenteve te Universitetit Epoka - Bashkia Berat bashkëpunon ngushtë me Universitetin Epoka Tirane. Me poshte foto nga vizita e fundit studimore qe studentet e arkitektures së Universitetit Epoka kryen ne Berat.



Kolonia e Artit Kolonia e Artit ne Berat u mbyll me nje ekspozite te organizuar ne Bulevardin e qytetit ne daten 12 Tetor 2014. Nje organizim i suksesshem i Institutit te Librit dhe Promocionit Toena, me mbeshtetjen financiare te Bashkise Berat dhe Fondacionit Shqiptaro Amerikan per Zhvillim.



Dita Botërore e Turizmit Në datën 27 Shtator, në Zyrën e Informacionit Turistik u shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes për të trajnuarit në programin e Zhvillimit të Guidave Turistike. Ceremonia u krye edhe në kuadrin e Ditës Botërore të Turizmit dhe Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.



Muzike Ndërmjet Dy Boteve – Event Muzikor i organizuar nga Muzeu Onufri me Muzikante Ndërkombëtar.



Festivali Ndërkombëtar “Jazz and Wine” Ky festival u organizua dhe drejtua nga artistja e njohur Eda Zari dhe gëzoi mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Berat si dhe një sërë aktoresh të tjere. Një mbrëmje gërshetuar me muzikë dhe verë në qytetin ku shija shkrihet natyrshëm me elegancën, bukurinë me traditën, historinë me vlerat. Qyteti mbi 2400 vjeçar i Beratit, ka mbledhur artistë të ardhur nga shtete të ndryshme të botës, të cilët kanë performuar muzikë në zemër të tij, në mjediset e muzeut “Etnografik”. Një festë vere, ofruar nga prodhuesit vendas, i është bashkuar eventit të titulluar “jazz and wine”



Festivali Multikulturor - Ne datat 21- 23 Gusht ne Berat u organizua per tre nete Festivali Multikulturor, me 12 aktivitete artistike te cilat synyan promovimin e Beratit dhe te vlerave te trashegimise kulturore qe ky qytet mbart.

Aktivitetet nisen ne daten 21 Gusht ora 18.00 ne pedonalen e qytetit, kuu organizuan ekspozita piktore te femijeve dhe te rinjve, shfaqje video-projeksionesh ne lagjen Gorice, Koncert Jazz nga Elina Duni ne mbremje ne Kala dhe me pas Dj ne pedonale per gjate gjithë mbremjes se 21 Gushtit, ku te rinjte festuan ne sheshin qendror te qytetit.

Ne daten 22 Gusht, ne oren 09.30 u hap ne pedonalen e qytetit panairi i artizanatit dhe agrobiznesit , i cili qendroi per dy dite rresht, ekspozita piktore ne sheshin para bibliotekes, animatore sociale argetuan femijet ne dy parqet e qytetit, parkun ne lagjen Deshmoret e Kombit dhe Parkun Para Bibliotekes. Nje konference per trashegimine kulturore u organizua ne Muzeun Onufri, dhe me pas ne mbremje Koncert Rroku i grupit anglez Bethia Beadman ne pedonale i cili u pasua nga Dj me muzike ne sheshin qendror.

Ne daten 23 Gusht vijoi panairi i artizanatit dhe agrobiznesit, ekspozita piktore, animatore per femijet ne pedonale dhe ne mbremje koncert i qendres kulturore , i grupeve nga komuniteti Rom dhe per te vijuar me koncertin e Dren Abazit ne sheshin qendror.



8 Korrik, përvejtori i Hyrjes së Beratit në UNESCO Me rastin e Datës 8 Korrik, 6 vjetorit të Hyrjes së Beratit në UNESCO, Bashkia Berat dhe DRKK Berat organizuan një event në Qendrën Mesjetare. Në event u organizuan disa ekspozita: Ekspozita Fotografike “Si e shohin të Rinjtë Qytetin dhe Trashegiminë”, Ekspozita “Udhëtim në Kohë”, një Ekspozitë Artizanale si dhe një Ekspozitë me Piktura nga Shkolla e Mesme Artistike “Ajet Xhindole”. Më herët në një konferencë për shtyp dhe në fjalimin e tij përshëndetës, Kryetari Fadil Nasufi vuri theksin mbi rëndësinë e vlerave tona kulturore dhe ruajtjen tyre. Në fund, grupi i këngëtarëve të Qendrës Kulturore Margarita Tutulani kënduan këngë qytetare beratase për të pranishmit. Kontribut në organizimin e eventit dhanë edhe vullnetarët e Korpusit të Paqes si dhe Agjencia për Nxitjen e Biznesit Social.



Panairi Kombëtar Lëvizës në Berat. Në datat 13-15 Qershor në qytetin e Beratit u zhvillua Panairi Kombëtar Lëvizës. Firma nga i gjithë vendi promovuan produktet e tyre. Në panair nuk munguan këngë dhe valle tradicionale Shqiptare.



Berat, Albania

© Copyright 2014 Jerianne Perry

Pastrimi i Lagjeve Historike me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit -

Bashkia Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore, shoqërinë Sipërmarrëse të Pastrimit dhe me senatet e shkollave, më datë 5 Qershor “ Ditën Botërore të Mjedisit” organizoi një aktivitet me moton : “PËR NJË JETË TË SHËNDETSHME DUHET NJË MJEDIS I PASTËR” Qëllimi i shënimit të kësaj ngjarje

është të nxisë aktivitete dhe aksione për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit dhe kjo ditë të kthehet në një festë tradicionale për qytetin e Beratit. Ky aktivitet u zhvillua në harkun kohor 10°-13°, i konceptuar në këtë mënyrë: 1- Aktiviteti fillojë në sheshin para Biblotekës ku u bë mbjellja me lule e dy parcelave të lulishtës nga anetaret e grupit ambasadoret e natyres, shkolla 9 - vjeçare “Xhemal Çekini” Uznovë, shkolla e mesme "Babë Dudë Karbunara" si dhe në bashkpunim me Qendrën Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim(EPER) dhe me Ndërmarrjen e Gjellbërimit. 2- Aktiviteti vazhdoi në ambientet e çdo shkolle dhe më pas vijoi në Lagjet Historike.



Organizimi i Pastrimit te Kalasë ne bashkëpunim me nxënës dhe anëtarë të Komunitetit në kuadër të sezonit turistik - Grupi Rinor Ambasadoret e Natyres, pjese e Qendres Rinore Berat, punonjes te Bashkise Berat dhe DRKK-Berat morren pjese ne nje fushate pastrimi dhe ndergjegjesimi ne Lagjen Kala.

Lagja Kala u perzgjodh si nje nga vendet qe ka me shume vizitueshmeri nga turistet ne Qytet dhe nevoja per higjiene dhe pasterti eshte shume e larte.



“Urat e Ballkanit Flasin” Ne datat 28, 29 Mars, Berati u kthye ne kreyqendren e festimeve ne Ballkan. Nen titullin “Urat e Ballkanit Flasin”, Bashkia Berat, Fondacioni Balcanica, Ministria e Kultures si dhe nje sere aktoresh te tjere, organizuan disa aktivitete te rendesishme te cilat u nderuan dhe me viziten e Drejtoreshes se Pergjithshme te UNESCO-s Znj. Irina Bokova dhe Ministres se Kultures Znj. Mirela

Kumbaro. Nje tryeze e rrumbullaket ftoi autoritete te rendesishme te diskutonin mbi trashegimine, pershire edhe kryetaret e Bashkive te Lovech, Bullgari, Podgorices, Struges, Mostarit etj. Aktivitetet vijuan me nje nje panair artizanati, ekspozita fotografike dhe pikturash, koncerte me grupe te ndryshme Ballkanike dhe u kurorezuan ne fund me nje spektakel 3 dimensional te shfaqur mbi Uren e Gorices per te transmetuar shekujt e historise qe ajo mban mbi supe.



“Une e Dua Lumin” 1000 te rinj + Federata e Rafting shkruajten ne buze te lumit Osum mesazhin: NE DUAM LUMIN me rastin e Ditës Ndërkombëtare e Veprimit për Lumenjtë. Çdo vit, mijëra njerëz në mbarë botën ngrejnë zërin e tyre për të festuar për lumenjtë e botës dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre.

Dita Ndërkombëtare e Veprimit për Lumenjtë është një ditë për të festuar mbrojtjen e lumenjve. Kjo është një ditë për të edukuar në lidhje me rëndësinë e lumenjve dhe për të kërkuar përmirësime në praktikën e vendimmarrësve. Kjo është një ditë për të edukuar njëri-tjetrin në lidhje me kërcënimet me të cilat përballen lumenjtë tanë, dhe të mësojmë në lidhje me ujin si një e mirë e njerëzimit. Mbi të gjitha, kjo është një ditë për të bashkuar - duke vepruar së bashku, pasi këto çështje nuk janë thjesht lokale, por në përmasa globale. Ky aktivitet është i regjistruar dhe i bashkohet nismës botërore të ndërmarrë nga organizata International Rivers dhe u mbështet nga Drejtoria Arsimore Rajonale Berat dhe Bashkia Berat.




Organizimin e 18 Prillit, Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe e siteve të Trashëgimisë Me rastin e 18 Prillit, Dites Nderkombetare te Monumenteve te Kultures, Bashkia Berat, Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare dhe Drejtoria Arsimore ne Berat organizuan nje sere aktivitetesh te cilat ne qender te tyre kishin rinine dhe trashegimine. Midis drejtorive u nenshkrua nje marreveshje e cila angazhon te rinjte te

marrin ne patronazh si dhe te studiojne dhe te mbrojne monumentet e kultures. Aktiviteti vijoi me nje ekspozite me piktura te pikturuara nga te rinjte, nje ekspozite fotografike, prezantim te projekteve te fundit ne fushen e trashegimise, nje lektorium mbi trashegimine dhe ne fund me nje fushate pastrimi dhe sensibilizimi me nexenesit e shkolles Babe Dude Karbunara dhe me nxenesit e shkolles 7 Nentori.



Informacion për Turistët

Harta të reja për Turizmin si dhe formateve shpjeguese ne lidhje me hotelet dhe restaurantet ne qytet.



Krijimi Kendi i Turistëve prane Zyres së Informacionit Turistik




Dizajni i Fletëpalosjeve për Zyren e Informacionit



Dizajni dhe Printimi i Posteri ne Panairin Kombetar Shetites




Dizajni dhe printimi i 33 Banerave per pjesemarrje ne Panaire



Promovim

- “Intervista per Grupin e Gazetareve Mobile America per vlerat e turizmit ne Berat”



Organizimin e Turit Promovues Invest Macedonia me gazetare nga Trevat Shqiptare



Emision Turistik per Beratin ne Televizionin Ora News



Interviste për Turizmin ne Televizionet Top Channel, Glob, A1 Report, Neës24, Ora Neës, TVSH etj.



Promovimi i Trashëgimisë dhe i Turizmit në Berat në Emisionin Dita e Shtatë në “Agon Channel”.



Faqja e Internetit Bashkia Berat

**BASHKIA BERAT**
MUNICIPALITY OF BERAT



KRYESORE | BERATI | BASHKIA | EKONOMIA | INVESTIME | PROJEKTE | KULTURA | TURIZMI | SOCIALE | SHËRBIMET | KONTAKT |  ALBANIAN

AKTIVITETET KULTURORE TURISTIKE DHE KULTURORE


Berati Ne Ora News 0


Përnairi Kombëtar Levizes 0


Ndergjegjesim Dhe Pastrim 0


Gazetare Dhe Biznesmene Maqedor:
Vizitojne Qytetin E Beratit 0


Berati ne Ora News

Denonco Abuzimet
Të dashur qytetarë! Klikoni këtu për të
denoncuar abuzime të mundshme që ju

Faqja e Internetit e Projektit SUSTCULT

- Integrated approach to cultural heritage planning and management
- Sustainable promotion of heritage sites and marketing activities
- Management Planning processes (achievements, opportunities, challenges)
- Funding opportunities within EU programmes 2014-2020

At the end of each session, the speakers will also be pleased to share and discuss project results with participants. Ample time will also be reserved during the day for networking. The official invitation to the Conference containing the draft programme and logistic information will be available in the coming weeks.

Save the date of 20 April 2014 for your calendar in order not to miss this important event!

KONFERENCA PERMBYLLESE, 8 PRILL LUBJANA

Fletpaloje Formulari Regjistrimit



BËHUNI FANS NË FACEBOOK

SUSTCULT project

Like

238 people like SUSTCULT project.

Facebook social plugin

PROJEKTI SUSTCULT »



PËRGATITET PLANI I MENAXHIMIT TË QENDRES HISTORIKE TË BERATIT

April 20, 2014, No Comments



Workshop në Vespem, Hungari

November 12, 2013, No Comments



Workshop mbi Planin e Veprimit

November 12, 2013, No Comments



Takim Në Hungari

November 12, 2013, No Comments

KËRKO

Search here..



SITET NË PROJEKT »



AKTIVITETE »



SHKRIMET E FUNDIT

Konferenca Europiane në Ljubljana, Slloveni

Përgatitet Plan i Menaxhimit të Qendres Historike të Beratit

Plan i Biznesit dhe Strategjia e Marketingut

Faqja e Facebook

